

SI TË KËRKONI MBËSHTETJE SHËNDETËSORE

Mbretëria e Bashkuar ofron shërbime shëndetësore falas për të gjithë përmes Shërbimit Kombëtar të Shëndetësisë (NHS). Kjo përfshin kujdes urgjent dhe jo urgjent, si dhe mbështetje për shëndetin mendor. Ky burim do t'ju shpjegojë se si mund të aksesoni këto shërbime sipas nevojës tuaj.

SHËRBIMET E URGJENCËS

Kur duhet të telefononi 999?

Telefononi 999 për urgjenca të rënda kur jeta është në rrezik. Kjo mund të përfshijë:

- Atake zemre ose simptoma të tjera serioze të papritura.
- Aksidente të rënda.
- Ndhmë të shpejtë ndaj dhimbjeve të forta ose gjakderdhjes së pakontrollueshme.



A&E: Accident and Emergency (Urgjenca)

Shkoni direkt në A&E për raste urgjente, si aksidente ose sëmundje të rënda, kur është e nevojshme ndihma e menjëhershme e mjekëve.

KUJDESI JO URGJENT (111)

Kur duhet të telefononi 111?

Nëse situata nuk është urgjente, por keni nevojë për këshilla mjekësore, telefononi 111. Ky shërbim është falas dhe ofrohet 24 orë të ditës. Kjo përfshin:

- Simptoma të reja ose të paqarta.
- Kërkim për shërbime lokale, si farmaci ose klinika të urgjencës.
- Këshillime mbi ilaçet.



MJEKU I FAMILJES (GP)

Për çfarë shërben GP?

Mjeku i familjes është pika e parë e kontaktit për shumicën e nevojave shëndetësore. Ata ofrojnë:

- Kontroll mjekësor të përgjithshëm.
- Diagnozë dhe trajtim për probleme jo urgjente.
- Referime te specialistët nëse është e nevojshme.

Si të regjistroheni me një GP?

- Zgjidhni një GP në zonën tuaj përmes website-it të NHS.
- Plotësoni formularin e regjistrimit dhe paraqisni dokumenta identifikimi (nëse keni, por dokumentet nuk janë gjithmonë të nevojshme).



MBËSHTETJE PËR SHËNDETIN MENDOR

Shërbimet Kryesore:

GP: Mund të flisni me mjekun tuaj të familjes për shqetësimet tuaja mendore dhe ata mund t'ju referojnë te specialistë ose grupe mbështetëse.

Shërbimet lokale: Përdorni 111 ose website-in e NHS për të gjetur shërbime për ankthin, depresionin ose mbështetje për sëmundje të tjera mendore.

Kriza mendore: Për krizë, kontaktoni ekipet e krizës së shëndetit mendor në zonën tuaj. Numrat janë të listuar në website-in e NHS.

KUJDESI DENTAR

Si funksionon shërbimi dentar në NHS?

Shërbimi dentar në NHS ofron kujdes të subvencionuar për të gjitha grupmoshat.

Falas për të miturit dhe grupe të tjera që kualifikohen:

- Kujdesi dentar është falas për të gjithë fëmijët nën 18 vjeç (ose deri në 19 vjeç nëse janë të angazhuar plotësisht në arsim).
- Të rriturit mund të marrin shërbime dentare të subvencionuara, por mund të kenë tarifa të vogla për trajtimet e ndryshme.



Si të gjeni një dentist të NHS?

- Përdorni website-in e NHS për të gjetur një dentist që pranon pacientë të rinj në NHS.
- Bëni një takim paraprak për të diskutuar trajtimet e mundshme dhe tarifat.

Urgjencat dentare:

Nëse keni dhimbje të mëdha ose probleme serioze dentare, telefononi 111 ose vizitoni një klinikë dentare për urgjenca.



MBËSHTETJE PËR MIGRANTË DHE PERSONA QË NUK FLASIN ANGLISHT

Mbështetje me Përkthim:

NHS ofron shërbime përkthimi falas në shumë spitale dhe klinika. Kërkojeni këtë shërbim kur rezervoni një takim.

Për migrantë pa dokumenta:

- Ju mund të aksesoni A&E dhe shërbime urgjente pa pasur dokumente të rregullta të imigracionit.
- Organizata si Doctors of the World ofrojnë ndihmë për ata që hasin vështirësi me aksesimin e shërbimeve.
- Nuk keni nevojë të keni një adresë të përhershme për tu regjistruar me një GP.

UKAMS nuk zëvendëson këshillat mjekësore të personalizuar nga një profesionist i licencuar të kujdesit shëndetësor.

Për shqetësime specifike mjekësore ose urgjenca, ju lutem kontaktoni direkt një ofruer të kujdesit shëndetësor ose kërkoni ndihmë të menjëhershme përmes shërbimeve të urgjencës. UKAMS është këtu për të ofruar mbështetje dhe informacion të përgjithshëm, jo këshilla mjekësore urgjente ose të individualizuara.

Kjo përmbajtje është përkthyer dhe përshtatur nga informacion që është i disponueshëm në faqen e internetit të NHS.

Ky burim u krijua në Dhjetor 2024

